



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

MINISTRI

Nr. 7759 / Prot.

Tiranë, më 17 / 11 / 2021

URDHËR

NR. 254, DATË 17 / 11 / 2021

PËR

DELEGIMIN E KOMPETENCAVE PËR PROCEDURA TË BURIMEVE NJERËZORE
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 28 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", nenit 11, pika 2 e ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", si dhe të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave Sekretarit të Përgjithshëm, për nënshkrimin e praktikave të Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Sekretari i Përgjithshëm nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca.
3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.
4. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse, për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Mirela KUMBARO FURXHI